



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 435/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkritazi me apelin e paraqitur nga Muharrem Svarça, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli i paraqitur nga Muharrem Svarça, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Vendvotimin 2506D/03R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 07.11.2019 në ora 14:40, nga Muharrem Svarça, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilin ka pretenduar se në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve, të paraqitur nga KQZ-ja, në numrin e kandidatit në fjalë (nr.28), janë shënuar 13 vota, ndërsa në raportin e vëzhguesit të LDK-së, në këtë vendvotim janë shënuar 19 vota. Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i që të rinumërohen fletëvotimet në VV 2506D/03R, për shkak të dyshimit se kandidati në fjalë është dëmtuar në vota.

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve në apel, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se apeluesi në apelin e paraqitur kërkon që të rinumërohen fletëvotimet e VV 2506D/03R, sepse në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve, të paraqitur nga KQZ-ja, në numrin e kandidatit në fjalë (nr.28), janë shënuar 13 vota, ndërsa në raportin e vëzhguesit të LDK-së, në këtë vendvotim janë shënuar 19 vota.

Paneli, vlerëson se apeli i apeluesit për rinumërim të fletëvotimeve në VV 2506D/03R, është i pa bazuar për arsye se KQZ-ja, ka bërë rinumërimin e votave për të njëjtin vendvotim dhe se rezultati i dalë nga ky rinumërim, është përfshirë në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja, më datë 07.11.2019, andaj paneli, për këtë arsye vlerëson se

përsëritja edhe njëherë e rinumërimit në vendvotimin e njëjtë konsiderohet e panevojshme në këtë rast.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.435/2019 më datë 09.11.2019

Kryesues i Panelit

Rrustem Thaqi



***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*